

Ahmeti, Ramës: Vazhdo rrugën drejt pajtimit dhe integritetit, me hasmëri nuk jetohe I FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS SË UÇK-SË I SHKRUAN LETËR EDHE KOMISIONARIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KËSHILLIN E EVROPËS (KIE)

OVLUÇK-ja I SHKRUAN LETËR KOMISIONARIT TË KIE-së: TË HETOHEN SHKELJET E SPECIALES



Pas përfaqësuesit të presidentit amerikan Donald Trump për misionet speciale, Richard Grenell, Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së i ka shkruar letër komisionarit për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës (KIE), Michael O'Flaherty, në lidhje

me Gjykatën Speciale. Në këtë letër, OVLUÇK-ja ka theksuar se nuk është duke e kundërshtuar drejtësinë, por duke e mbrojtur atë. Kjo organizatë ka vlerësuar se Specialja nuk është duke i përngjarë një institucioni gjyqësor të ndërtuar mbi vlerat

evropiane, por është shndërruar në një strukturë të mbyllur hermetikisht. Me këtë rast, OVLUÇK-ja ka kërkuar nga komisionari i KIE-së që të ketë hetim ndërkombëtar për shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut dhe abuzimet procedurale brenda Speciales

KUVENDI I KOSOVËS
NUK KONSTITUOHET
AS NË PËRPIEKJEN
E 18

**ASGJË E RE
NGA KUVENDI**

F. 4



**'AMBASADORJA'
AMERIKANE VIZITON
VERIUN: QEVERIA T'I
SIGUROJË QYTETARËT
TË JETOJNË NË
MËNYRË PAQËSORE**

F. 7



**KOMUNA E PRISHTINËS,
KONTRATË 1.5-MILIONËSHE ME
'PASTRIMIN' PËR PUNË SHITESË**

F. 8



**PUNËTORËT E 'INFRAKOS'-it DHE
TË 'TRAINKOS'-it PROTESTOJNË
PËR RITJE PAGASH,
PARALAJMËROJNË
'BLOKADË TOTALE'**

F. 8

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ish-presidenti amerikan Joe Biden diagnostikohet me kancer në prostatë

UASHINGTON, 19 MAJ - Ish-presidenti amerikan Joe Biden është diagnostikuar me një formë “agresive” të kancerit në prostatë, që tashmë i është përhapur në kocka, thuhet në një deklaratë të zyrës së tij të publikuar të dielën. Ai dhe familja e tij po shqyrtojnë opsionet e trajtimit me mjekët. Bideni është diagnostikuar të premten e javës së kaluar, pasi

kishte shfaqur simptoma urinare, është thënë në një deklaratë. “Ndonëse bëhet fjalë për një formë më agresive të sëmundjes, kanceri duket të jetë i ndjeshëm ndaj terapisë hormonale, gjë që mundëson një menaxhim efektiv”, ka sqaruar zyra e tij. Pas këtij lajmi kanë pasuar reagime të shumta. Në mesin e tyre, ka reaguar edhe presidenti

amerikan Donald Trump, i cili i ka uruar Bidenit shërim të plotë. Po ashtu, edhe nga Kosova Bidenit i kanë uruar shërim. Në mesin e tyre, ish-ministri i Jashtëm, Enver Hoxhaj dhe ish-ambasadorja e Kosovës në Uashington, Vlora Çitaku. Mandati i Bidenit president ka përfunduar më 20 janar, kur Donald Trump është betuar president i ShBA-së.



Fitorja befasuese e Nicusor Danit në zgjedhjet presidenciale rumune sjell lehtësim për BE-në dhe NATO-n

BUKURESHT, 19 MAJ - Pas muajsh trazirash politike, zgjedhjeve të anuluar dhe ndalimit të kandidatit kryesor ultranacionalist, Rumania më në fund ka zgjedhur një president të ri, një zhvillim që i ka dhënë lehtësim Brukselit. Kryetari centrist i Bukureshtit, pro Bashkimit Evropian dhe pro Ukrainës, Nicusor Dan, tani hyn në skenën ndërkombëtare, ndërsa pranë kufijve të Rumanisë vazhdon lufta më e madhe në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. “Rumania kishte një zgjedhje të qartë në këto zgjedhje: të vazhdonte kursin properëndimor apo të rreshtonte drejt ultranacionalizmit dhe mbështetjes për Rusinë. Me zgjedhjen e Nicusor Danit, rumunët zgjedhën vazhdimësinë properëndimore. Do të ketë një frymë lehtësimi si në BE, ashtu edhe në NATO, ku Rumania është një anëtare e qëndrueshme prej dekadash. Ajo ka një pozicion strategjik të rëndësishëm”, ka thënë Oana Lungescu, eksperte në Institutin Mbretëror për Shërbimet e Bashkuara (RUSI) në Mbretërinë e Bashkuar dhe ish-zëdhënëse e Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO), në një



prononcim për “Radion Evropa e Lirë”. Zgjedhja e Danit më 18 maj është e jashtëzakonshme për disa arsye. Ai ka fituar rreth 54 për qind të votave, duke mposhtur kandidatin ultranacionalist 38-vjeçar George Simion në balotazh. Ai nuk ka marrë pjesë fare në rundin e parë të zgjedhjeve të nëntorit të kaluar, kur kishte nisur mandatin e dytë si kryebashkiak i Bukureshtit. Por, pasi ato zgjedhje ishin anuluar mes akuzave për ndërhyrje ruse, Dan kishte vendosur të garojë në përsëritjen e tyre në maj. “Jemi në një moment ekuilibri, më të vështirë që nga viti 1989”, ka thënë ai, duke iu referuar vitit të përmbysjes së regjimit komunist

në Rumani. Po aq e habitshme është edhe mënyra si ai arriti të përmbysë rezultatit. Në rundin e parë, ishte vetëm pak për qind para kandidatit të tretë, Crin Antonescu, dhe rreth 20 për qind prapa Simionit. Megjithatë, ka arritur të mbyllë hendekun dhe ta mposhtë atë. Tani, Dan përballat me sfidën e madhe për të qetësuar tensionet politike në një vend thellësisht të polarizuar. Ai ka garuar si i pavarur, duke mposhtur si kandidatët e koalicionit qeverisës, ashtu edhe të opozitës, që mbështetën Simionin. Kjo mund ta ndihmojë të paraqitet si figurë unifikuese, por gjithashtu e detyron të ndërtojë një bazë

mbështetjeje në parlament. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për njërin nga detyrat e para të tij: emërimin e një kryeministri të ri që mund ta sigurojë shumicën. “Nuk është e lehtë, është e komplikuar, sepse parlamenti është shumë i fragmentuar”, ka thënë analisti Sergiu Miscoiu nga Fakulteti i Studimeve Evropiane në Universitetin e Clujit, në një prononcim për “REL”-in. Presidenti në Rumani ka një rol gjysmë ekzekutiv, me përgjegjësi të rëndësishme në politikën e jashtme, përfshirë pjesëmarrjen në samite ndërkombëtare dhe ushtrimin e vetos në BE. Dan ka deklaruar se dëshiron marrëdhënie të ngushta me Shtetet e Bashkuara, ruajtjen e një qëndrimi të qëndrueshëm pro BE-së dhe vazhdimin e mbështetjes për Ukrainën. Zgjedhja e tij është pritur me pozitivitet në Bruksel dhe në kryeqytetet e tjera evropiane, ku Dan shihet si një aleat natyral dhe i besueshëm. Presidenti francez, Emmanuel Macron, dhe kryeministri polak, Donald Tusk, madje kanë shprehur publikisht mbështetjen për Danin vetëm dy ditë para zgjedhjeve.

Pas fitores, të dy liderët e kanë përgëzuar menjëherë Danin. “Pavarësisht përpjekjeve të shumta për manipulim, rumunët zgjedhën demokracinë, sundimin e ligjit dhe Bashkimin Evropian”, ka deklaruar Macron, i cili ka thënë se kishte folur në telefon me Danin pas publikimit të rezultateve. Administrata Trump, në kontrast, ka qenë shumë kritike ndaj vendimit për të anuluar zgjedhjet e vitit të kaluar, gjë që ka gëzuar mbështetësit e Simionit. Dan ka shprehur mbështetje të palëkundur për NATO-n dhe synon të ruajë mbështetjen e Uashingtonit, veçanërisht duke marrë parasysh që Shtetet e Bashkuara kanë një bazë raketore anti-balistikë dhe rreth 1.700 trupa të vendosur në Rumani. Mes zërave për tërheqjen e mundshme të trupave amerikane nga Evropa, kjo mund të jetë një sfidë tjetër për presidentin e ri rumun. “Çdo president që zgjidhet mbi një platformë pro-evropiane do të kishte disa probleme me administratën Trump. Por Nicusor Dan nuk është aspak një majtist. Është, le të themi, një konservator i moderuar. Kjo mund ta ndihmojë atë në dialog me Shtëpinë e Bardhë”, ka thënë Miscoiu.

Diplomatët: BE-ja dhe Britania janë pajtuar për ‘rinisje’ të raporteve

LONDËR, 19 MAJ - Negociatorët e Bashkimit Evropian (BE-së dhe ata të Mbretërisë së Bashkuar kanë arritur pajtim për një marrëveshje për “rinisjen” e raporteve të tyre pas Brexitit, kanë bërë me dije disa diplomatë të hënën, teksa kryeministri britanik, Keir Starmer, po përgatitet t’i presë shefat e bllokut evropian në një samit në Londër gjatë 19 majit. Diplomata të BE-së kanë thënë se shtetet anëtare i kanë dhënë dritën e gjelbër një treshe tekstesh që pritet të nënshkruhen në samit: një

partneritet për siguri dhe mbrojtje, një deklaratë të solidaritetit BE - Mbretëri e Bashkuar dhe një Mirëkuptim të Dyanshëm për çështje të ndryshme, nga tregtia dhe peshkimi, deri te lëvizja e të rinjve, raporton agjencia franceze e lajmeve “AFP”. Bisedimet është thënë të kenë zgjatur deri në natën e së dielës për zgjidhjen e disa pikave kyçe, teksa çështja e ndjeshme e të drejtave të peshkimit ka qenë në krye të listës. Sipas marrëveshjes përfundimtare, Britania do t’i



mbajë ujërat e hapura për peshkatarët evropianë për 12 vjet, pasi të skadojë marrëveshja

aktuale më 2026, në këmbim të lehtësimit pa afat të caktuar të rregullave të bllokut për

importet e ushqimeve nga Mbretëria e Bashkuar. Sa i përket çështjes së lëvizjes së të rinjve, një burim tjetër kyç i përplasjes, teksa Londra druan se një skemë e tillë mund të shpie në kthim të lirisë së lëvizjes ndërmjet BE-së dhe Britanisë - negociatorët raportohet të jenë pajtuar në përgjithësi për pikat kryesore. Britania braktisi Bashkimin Evropian më 1 shkurt 2020, pas një referendumi të mbajtur më 2016, ku 51.89 për qind e pjesëmarrësve zgjedhën të ashtuquajturin Brexit, largimin nga blloku evropian.

ORGANIZATA E VETERANËVE TË LUFTËS SË UÇK-SË I SHKRUAN LETËR EDHE KOMISIONARIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KËSHILLIN E EVROPËS (KIE)

OVLUÇK-ja I SHKRUAN LETËR KOMISIONARIT TË KIE-së: TË HETOHEN SHKELJET E SPECIALES

Pas përfaqësuesit të presidentit amerikan Donald Trump për misione speciale, Richard Grenell, Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së i ka shkruar letër komisionarit për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës (KiE), Michael O'Flaherty, në lidhje me Gjykatën Speciale. Në këtë letër, OVLUÇK-ja ka theksuar se nuk është duke e kundërshtuar drejtësinë, por duke e mbrojtur atë. Kjo organizatë ka vlerësuar se Specialja nuk është duke i përngjarë një institucioni gjyqësor të ndërtuar mbi vlerat evropiane, por është shndërruar në një strukturë të mbyllur hermetikisht. Me këtë rast, OVLUÇK-ja ka kërkuar nga komisionari i KiE-së që të ketë hetim ndërkombëtar për shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut dhe abuzimet procedurale brenda Speciales

EPOKA
ERE

Lirim GECI

Prishtinë, 19 maj - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së i është drejtuar me një letër komisionarit për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës (KiE), Michael O'Flaherty, në lidhje me Gjykatën Speciale në të cilën po mbahen në paraburgim liderët e UÇK-së dhe disa luftëtarë të lirisë. Në letër është thënë se i janë drejtuar komisionarit O'Flaherty "jo për ta kundërshtuar drejtësinë, por për ta mbrojtur atë".

Po në letër është thënë se Gjykata Speciale nuk është duke i ngjarë më një institucioni gjyqësor të ndërtuar mbi vlerat evropiane të të drejtave të njeriut, por është shndërruar në një strukturë të mbyllur hermetikisht, që funksionon në izolim të plotë nga sistemi ligjor i Kosovës, institucionet e saj demokratike dhe mekanizmat e mbikëqyrjes kushtetuese. Në funksion të kësaj, OVLUÇK-ja edhe në emër të shoqatave të tjera të dala nga lufta çlirimtare ka kërkuar hetim ndërkombëtar për shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut dhe abuzimet procedurale brenda Gjykatës Speciale.

Të dielën OVLUÇK-ja i ka shkruar letër edhe përfaqësuesit të presidentit amerikan, Donald Trump, për misione speciale, Richard Grenell, lidhur me shkeljet që, sipas kësaj organizate, është duke i bërë Gjykata Speciale në Hagë ndaj liderëve dhe ushtarëve të tjerë të UÇK-së të akuzuar, kinse, për krime lufte. Në letër drejtuar Grenellit, kjo organizatë ka vlerësuar se Specialja duhet të mbyllet sepse "është një turp për drejtësinë

amerikane dhe për vlerat amerikane". Në letër është bërë thirrje edhe për një rishikim të plotë të funksionimit të Speciales, duke përfshirë një auditim financiar të fondeve të saj.

Katërshja e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, janë duke u mbajtur në paraburgim që nga nëntori i vitit 2020. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka hyrë në fazën përfundimtare. Përpos tyre, në Hagë janë duke u mbajtur edhe disa nga eprorët e UÇK-së.

Letra e plotë e OVLUÇK-së drejtuar komisionarit O'Flaherty:

I nderuar komisioner Michael O'Flaherty,

Po ju drejtohem si Organizata e Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK), jo për të kundërshtuar drejtësinë, por për të mbrojtur atë. Ne kemi qenë ndër mbështetësit më të fortë të drejtësisë ndërkombëtare dhe të llogaridhënies. Besojmë, ashtu si shumë në shoqërinë tonë, se e vërteta dhe drejtësia jo vetëm që mund të përballojnë çdo shqyrtim, por duhet të ndiqen përmes procedurave juridike të bazuara në parime dhe paanshmëri. Ne e mirëpritëm idenë e një drejtësie që do të funksiononte përtej politikës së pushtetit, me integritetin për të dalluar mes hakmarrjes dhe ligjit. Këtë e ndjemë si detyrë ndaj bashkëqytetarëve tanë, dhe mbi të gjitha, ndaj kujtimit të atyre që dhanë jetën për të mbrojtur të drejtën për të jetuar

të lirë nga tirania.

Por ajo që filloi si një instrument ligjor drejtësie është shndërruar në diçka krejt tjetër. Sot, Dhomat e Specializuara nuk i ngajnë më një institucioni gjyqësor të ndërtuar mbi vlerat evropiane të të drejtave të njeriut. Ato janë shndërruar në një strukturë të mbyllur hermetikisht, që funksionon në izolim të plotë nga sistemi ligjor i Kosovës, institucionet e saj demokratike dhe mekanizmat e mbikëqyrjes kushtetuese. Procedurat e tyre janë të njollitura nga paraburgimet e tejzgjatura, redaktimet e tepëruara të dokumenteve, vonesat në dorëzimin e provave dhe kufizimet në ndihmë juridike. Dhomat e specializuara refuzojnë të marrin parasysh edhe Avokatin e Popullit të Kosovës, institucionin që ekziston pikërisht për të mbrojtur të drejtat themelore dhe i cili ka të drejtë të plotë, si në kuadër të sistemit ligjor të Kosovës, ashtu edhe sipas të drejtës ndërkombëtare, të hetojë shkeljet e mundshme. Por qëndrimi i gjykatës është i qartë, ato nuk japin as përgjigje, as shqyrtim, as llogaridhënie. Kjo nuk është thjesht një çështje ligjore. Kjo është një çështje e të drejtave të njeriut. Ata që i nënshtrohen procesit nuk trajtohen më si qytetarë të pafajshëm deri në provën e fajësisë. Ata mbahen, për vite me radhë, në kushte që shkatërrojnë dinjitetin, familjet dhe të drejtat e tyre. Ata gjykojnë jo vetëm përpara një

trupit gjyqësor, por në një sistem ku prokuroria gëzon fuqi të pakufizuar, dhe ku të drejtat e mbrojtjes jo vetëm dobësohen, por pengohen aktivisht. Për këto arsye, jemi të detyruar të bëjmë një krahasim të dhimbshëm, por të nevojshëm, tashmë ky institucion po fillon të ngajë me një inkuizicion e jo një gjykatë drejtësie. I mbuluar me gjuhë ligjore, ai vepron pa kontroll efektiv, pa pjesëmarrje vendore dhe pa mbikëqyrjen që e kishte dalluar një sistem drejtësie nga një mekanizëm shtypës. Gjykon, ndjek penalisht dhe mban në paraburgim, të gjitha brenda një strukture të mbyllur që refuzon të njohë instrumentet dhe institucionet ligjore të Republikës së Kosovës. Kjo nuk është vetëm një dështim procedural por është një tradhti ndaj premtimit të drejtësisë. Nuk jemi të vetmit që shprehim këtë shqetësim. Juristë të respektuar, organizata të shoqërisë civile dhe madje edhe ish zyrtarë brenda vetë Dhomave të Specializuara kanë paralajmëruar se drejtimi aktual rrezikon jo vetëm të delegjitimojë institucionin, por edhe të shkaktojë dëme të parikoperueshme ndaj besimit publik në drejtësinë ndërkombëtare. Kur drejtësia ndjehet vetëm nga të akuzuarit, dhe kurrë nga shoqëria në emër të së cilës ajo ushtrohet, atëherë nuk flasim më për drejtësi. Flasin për shtrëngim. Për këtë arsye, dhe me respekt të plotë për mandatin tuaj dhe për parimet e Këshillit të

Evropës, ju drejtojmë këtë kërkesë: të fillohet menjëherë një hetim ndërkombëtar i pavarur për shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut dhe abuzimet procedurale brenda Dhomave të Specializuara për Kosovën.

Ky hetim duhet të udhëhiqet nga ekspertë të pavarur të së drejtës dhe të të drejtave të njeriut, jashtë strukturës aktuale institucionale të gjykatës. Duhet t'i jepet mandati për të vlerësuar përputhshmërinë e gjykatës me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, trajtimin e të paraburgosurve, kufizimet procedurale të të drejtave të mbrojtjes, përjashtimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe privilegjet joproporcionale të zyrtarëve të saj.

Drejtësia nuk mund të ekzistojë në një vakum. Asnjë institucion, sado fisnik të jetë në origjinë, nuk qëndron mbi shqyrtimin dhe llogaridhënie. Asnjë gjykatë evropiane nuk duhet të lejohet të funksionojë pa përputhshmëri të plotë me vlerat evropiane që ajo pretendon të përfaqësojë. Ne kemi luftuar për të përfunduar tiraninë, jo për të parë se si ajo ringjallet në formën e institucioneve ligjore të paprekshme.

I nderuar komisioner, ju bëjmë thirrje të veproni.

Me respektin më të thellë,

Organizata e Veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL, ShIL, ShFD-UÇK)

KUVENDI I KOSOVËS NUK KONSTITUOHET AS NË PËRPPJEKJEN E 18

ASGJË E RE NGA KUVENDI

As për të herë të 18 nuk është konstituuar Kuvendi i Kosovës. Deputetët e opozitës së deridjeshme janë duke refuzuar për të dhjetën herë që ta formojnë një komision për mbikëqyrjen e një votimi të fshehtë për kryetarin e ri të Kuvendit, i cili, sipas tyre, është kundërkushtetues. Në këtë kontekst, ata e kanë fajësuar Vetëvendosjen për bllokimin e formimit të institucioneve të dala nga zgjedhjet e shkurtit. Sipas tyre, tani është koha që presidentja t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Nesër (e mërkurë) do të tentohet përsëri të konstituohet Kuvendi



Kadrijaj ka thënë se kandidatja për kryeparlamentare, Albulena Haxhiu, do të duhej të adresohet për çmim Nobel për dështim. “Ndoshta ish dashtë mu adresuar edhe për çmim nobel, Albulena Haxhiun për dështim sepse nuk e besoj që ka ndonjë kandidat në asnjë instancë që ka dështim të tillë”, ka thënë Kadrijaj, duke bërë me dije se në Gjykatën Kushtetuese do të dërgojnë edhe komente të tjera sa i përket lëndës për votim të fshehtë.

Limaj: Duhet t'i thërrasin ndërgjegjes të gjithë, Kosovën e presin shumë telashe

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, duke folur për moskonstituimin e Kuvendit, ka thënë se Kosovën e presin shumë telashe. Limaj ka deklaruar se Kosova ka nevojë për qeveri efektive. Në këtë kontekst, ai ka thënë se janë të gatshëm ta japin kontributin e tyre. “Forcat politike janë këto, rruga e vetme që Kosova si shtet është përmes bisedimeve. Secili duhet t'i thërrasë ndërgjegjes, në mënyrë që të përfundojë kjo situatë. Kosovën e presin shumë punë, telashe. Gjashtë muaj nuk kemi qeveri efektive. Vendi ka nevojë. Na presin projekte, punë. Ne jemi të gatshëm ta japim kontributin tonë, por forcat e mëdha e kanë përgjegjësinë kryesore”, ka thënë Limaj.

Basha e akuzon opozitën e deridjeshme për moskonstituimin e Kuvendit

Deputeti i Vetëvendosjes, Dimal Basha, ka thënë se si parti nuk bëjnë koalicion me PDK-në pasi kjo parti, sipas tij, nuk është reformuar. Ai ka thënë se është e rëndësishme që sa më shpejt të dalë vendimi i Gjykatës Kushtetuese në lidhje me kërkesën e AAK-së për votimin e fshehtë në Kuvend. Në këtë aspekt, Basha ka fajësuar opozitën e deridjeshme për moskonstituimin e Kuvendit. “LV-ja ka treguar që është konstruktive në të gjitha hapat që kanë pasur për qëllim zhbllokimin. Është i pakuptueshëm gjithë ky bllokim që është duke ardhur nga opozita. Me PDK-në nuk bëjmë koalicion, se nuk është reformuar. Me LDK-në po”, ka thënë Basha.

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 MAJ - Për të tetëmbëdhjetën herë me radhë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar të hënë ta konstituojnë përbërjen e nëntë parlamentare të dalë nga zgjedhjet e 9 shkurtit. Deputetët kanë refuzuar për të dhjetën herë rresht që ta formojnë një komision për mbikëqyrjen e një votimi të fshehtë për kryetarin e ri të Kuvendit. Çështja e votimit të fshehtë që është propozuar më 1 maj nga kryesuesi i seancës, Avni Dehari, pasi e propozuara e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, nuk ka arritur në disa votime t'i merrte 61 votat e nevojshme për t'u konfirmuar në pozitë, është dërguar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nga partitë që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë. Deputetët e opozitës kanë thënë se është jokushtetuese mënyra se si LV-ja po tenton që kryeparlamentari të votohet përmes formës së fshehtë, prandaj i kanë kërkuar Kushtetueses të marrë “një masë të përkohshme për ndalim të mbajtjes së seancave, dhe me prioritet ta trajtojë këtë lëndë dhe ta marrë një vendim”. Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe refuzuan sërish, në vazhdimin e seancës konstituive, më 19 maj, që ta propozonin një përfaqësues që

do të siguronte mbarëvajtjen e votimit të fshehtë. Seanca konstituive do të vazhdojë të mërkurën e 21 majit nga ora 10:30. Deri më tani deputetët kanë kaluar vetëm dy pika të agjendës së seancës konstituive: raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe atë të Betimit të Deputetëve. Por, procesi ka ngecur te pika e tretë: zgjedhja e kryeparlamentarit. Haxhiu e LV-së po konsiderohet figurë përçarëse nga dy parti parlamentare: PDK-ja dhe AAK-ja. Këto dy subjekte kanë kërkuar që LV-ja të nxjerrë emër tjetër për kryeparlamentar. LDK-ja, ndërkaq, ka thënë se nuk ka vota për asnjë të propozuar të LV-së për postin e kryeparlamentarit. Propozimi për kryeparlamentar është e drejtë ekskluzive e fitueses së zgjedhjeve, LV-së, e cila ngul këmbë se Haxhiu e meriton të zgjidhet dhe, ndonëse ka kërkuar marrëveshje politike me partitë e tjera, e ka përjashtuar mundësinë të sjellë kandidat tjetër pos saj. Të enjten e kaluar, pas një takimi të thirrur nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, me përfaqësues të partive politike, Osmani tha se nuk pati pajtim rreth konstituimit të Kuvendit, por shtoi se kishte parë një “disponim minimal” te liderët partiakë për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje. Deputetët duhet ta zgjedhin kryetarin dhe pesë nënkryetarët për ta konstituuar përfundimisht Kuvendin e ri. Vetëm pas

konstituimit të Kuvendit mund të formohet qeveria e re.

Krasniqi: LV-ja nuk ka vullnet për marrëveshje, është koha për interpretim nga Gjykata Kushtetuese

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka folur sërish pas dështimit të 18 të konstituimit të Kuvendit të Kosovës. Krasniqi ka thënë Vetëvendosja dëshiron ta vazhdojë agoninë e themelimit të institucioneve. “Sot patën përpjekjen e njëjtë që të shtyhen këto seanca që të mbahen në kundërshtim me Rregulloren një herë në javë, por vullneti i partive të tjera ishte që kjo të mos ndodhë”, ka thënë Krasniqi. Krasniqi ka thënë se nuk do të ishte fare e gabueshme nëse mblidhemi çdo ditë, ndoshta një presion ndaj njëri-tjetrit që të dilet nga kjo situatë. “Nuk pres që një gjë e tillë të ndodhë për shkak të faktit tashmë të dëshmuar që LV-ja nuk është e interesuar ta zhbllkojë situatën”, ka thënë kryetari i PDK-së. Më tutje, ai ka thënë se shpreson që presidentja Vjosa Osmani do t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese sesi duhet të veprojë.

Abdixhiku: E pakuptimtë, LV-ja s'mund të bëjë një shumicë minimale

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir

Abdixhiku, ka folur pas dështimit të seancë së 18 të seancës konstituive. Ai ka thënë se mungesa e urgjencës është lajm i keq për Republikën e Kosovës. Ai ka thënë se Kosova ka nevojë për institucione. “Për shkak se s'ka urgjencë, ka edhe zvarritje. Për shkak se s'ka urgjencë, ka edhe propozime që seanca të mos mbahet sipas rregullores. E mungesa e urgjencës është një lajm i keq për Republikën e Kosovës, sepse Kosova ka nevojë për institucione, ka nevojë për veprime politike të partisë së parë”, ka thënë Abdixhiku. Ai ka shtuar se është e pakuptimtë që LV-ja nuk po arrin të bëjë një shumicë minimale. “E pakuptueshme që një parti me 48 deputetë nuk arrin të bëjë një shumicë minimale”, ka thënë Abdixhiku.

Kadrijaj thotë se Haxhiu do të duhej të nominohej për çmim Nobel për dështim

Deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Time Kadrijaj, ka thënë se nuk e ka obligim ligjor dhe kushtetues ta votojë kandidatin e partisë tjetër. “Ne si AAK në këtë rast apo partitë të tjera nuk e kanë obligim ligjor as kushtetues të votojnë një kandidat që është i një partie tjetër përderisa nuk ka një koalicion ose përderisa nuk ka ndonjë marrëveshje. Po shihet se janë bllokuar”, ka thënë Kadrijaj. Lidhur me dështimin e 18 të konstituimit të Kuvendit,

PACOLLI: LV-ja PO E TRAJTON KOSOVËN SIÇ E TRAJTOJNË HIENAT VIKTIMËN

PRISHTINË, 19 MAJ - Presidenti i Aleancës Kosova e Re (AKR), Behgjet Pacolli, e ka akuzuar Vetëvendosjen për situatën e krijuar në Kuvend. Pacolli ka thënë se moskonstituimi i Kuvendit është krizë serioze kushtetuese dhe institucionale. “Çfarë loje po luan mazhoranca? Është për të ardhur keq dhe për t’u turpëruar se si mazhoranca ende nuk po kupton që qytetarët ia kanë dhënë besimin për të qeverisur me përgjegjësi, jo vetëm për të zbatuar politika dhe reforma, por edhe për të zgjidhur me urgjencë problemet institucionale kur ato shfaqen. Moskonstituimi i Kuvendit është një krizë serioze kushtetuese dhe institucionale, dhe zgjidhja e saj nuk mund të vonohet më. Ky është një problem që kërkon përgjigje të menjëhershme dhe vendimmarrje të guximshme, e para dhe mbi të gjitha nga mazhoranca. Mazhoranca nuk mund të fshihet pas alibive politike. Ajo është bartësja e legjitimitetit dhe përgjegjësisë për funksionimin e institucioneve. Opozita, sado

e zëshme të jetë, ka një rol dytësor në këtë proces. Nëse kandidatja e propozuar për kryetare Kuvendi nuk gëzon konsensus ose krijon përplasje politike, atëherë ajo është dashur të tërhiqet menjëherë për t’i hapur rrugë një zgjidhjeje të re dhe funksionale”, ka shkruar Pacolli në rrjete sociale. Ai ka thënë se partia fituese e zgjedhjeve është duke e trajtuar Kosovën siç e trajtojnë hienat viktimën. Ish-presidenti i Kosovës ka theksuar se kandidatja për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, nuk ka reflektuar aspak karshi situatës. “Nuk kuptohet se si kandidatja nuk ka reflektuar pas gjithë këtyre refuzimeve të njëpasnjëshme. Kur një person refuzohet tetëmbëdhjetë herë për të njëjtin post, është e qartë se nuk është e dëshiruar – as nga opozita, ndoshta as nga një pjesë e vetë mazhorancës. Rënia e saj në këtë pikë tregon një mungesë vetëdijeje politike dhe etike. Kjo këmbëngulje e pakuptimtë, më shumë sesa ambicie, po shndërrohet në pengesë për funksionimin e shtetit.



Përkundrazi, mazhoranca po e shndërron këtë proces të rëndësishëm në një lojë të brendshme force, ku kandidatja po trajtohet si ‘guxhja’ e radhës në një lojë të lodhur të ‘guxhave’, siç e quajnë me ironi qytetarët. Kjo

qasje është tallje me institucionet dhe me qytetarët që presin rezultate, jo spektakël politik. Kam frikë se qytetarët ende nuk e kanë kuptuar se partia fituese e zgjedhjeve po e trajton Kosovën siç e trajtojnë hienat

viktimën. Kosova po përballet me probleme serioze për shkak të mungesës së leadershipit, dhe për këtë po i vuajmë pasojat - pasoja që, për fat të keq, pritet të jenë edhe më të rënda”, ka shkruar Pacolli.

AHMETI, RAMËS: VAZHDO RRUGËN DREJT PAJTIMIT DHE INTEGRIMIT, ME HASMËRI NUK JETOHET

Shkup, 19 maj - Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, i është drejtuar me një letër kryeministrit të Shqipërisë, Edi Ramës, pas fitores në zgjedhjet e 11 majit. Ai ka shprehur gëzim se Rama do ta anëtarësojë Shqipërinë në Bashkimin Evropian. “I nderuar kryeministër i Republikës së Shqipërisë, kryetar i Partisë Socialiste, shumë i dashur Edi, s’kishte mënyrë më të mirë se sa ta shpallësh fitoren e Shqipërisë Evropiane, ashtu siç i ka hije, nga sheshi i kryeheroit tonë kombëtar hijerëndë, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, ku edhe u kurorëzove dhe e vulose atë fitore edhe me pjesëmarrjen e të gjithë krerëve



të shteteve evropiane në Tiranë. Prandaj dhe sot, pasi i përfundove të gjitha sfidat me sukses, vendosa të ta uroj,

vëllazërisht nga zemra, fitoren spektakolare dhe plebshitare të zgjedhjeve parlamentare. U gëzova shumë që pikërisht ty të

ra barra ta shpiesh Shqipërinë në Evropë, aty ku na e përcaktuan vendin rilindasit tanë, sepse e di që ti do t’ia dalësh dhe do ta realizosh, e ne të gjithë do të të mbështesim”, ka thënë Ahmeti.

Në këtë kontekst, Ahmeti i ka thënë Ramës ta vazhdojë rrugën drejt pajtimit dhe paqes sepse, sipas tij, nuk jetohet më hasmëri. “Prandaj, Edi, vijo rrugën drejt pajtimit dhe integritetit sepse në hasmëri shekullore nuk jetohet. Rajonit i duhet pajtim dhe integritet. Mua më ke pas, të ta hap rrugën e të ta ruaj shpinën. Ishe pranë nesh në çdo hap, edhe kur e bëmë gjuhën shqipe zyrtare, edhe kur u dakorduam për

korridorin 8 nga Shkupi në Tiranë që e pranove pa asnjë hamendje, edhe kur e hoqëm kufirin mes nesh, për abetaren e unifikuar, dhe për çdo gjë tjetër në të mirën e përbashkët dhe në funksion të së ardhmes evropiane. Edi, kemi ende shumë punë për të bërë, koha po dëshmon se të arriturat tona duhet mbrojtur sepse po cenohen vrazhdë me tendencë shqetësuese dhe ne nuk do ta lejojmë kthimin pas, por do të punojmë bashkë për të ecur përpara. Të përqafoj si vëllai-vëllanë, të uroj shëndet e mbarësi e me mall pres të ritakohemi e ta shtrijmë rrugën tonë të përbashkët evropiane”, është shprehur Ahmeti në urimin e tij për Ramën.

Kurti takohet me ambasadorin e ri italian, i shpreh mirënjohjen për mbështetjen e integritetit euroatlantik të Kosovës

PRISHTINË, 19 MAJ - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka pritur në takim mirëseardhës ambasadorin e ri të Italisë në Prishtinë, Maurizio Antonini. Në këtë takim të parë, Kurti e ka uruar ambasadorin për detyrën e re, teksa ka vlerësuar lart kontributin e vazhdueshëm

të Italisë për vendin tonë. Gjatë bisedës është nënvizuar partneriteti i fortë ndërmjet dy vendeve, veçanërisht roli i rëndësishëm i Italisë në mbështetjen e paqes dhe sigurisë përmes kontributit të saj në misionin e NATO-s, KFOR. Po në këtë takim është diskutuar edhe për nevojën

dhe mundësitë për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit bilateral, me fokus në fushën e ekonomisë, sigurisë e mbrojtjes dhe shkëmbimeve kulturore. Kryeministri në detyrë ka shprehur mirënjohjen për mbështetjen e Italisë në integrimin euroatlantik të Republikës së Kosovës.



IKSHPK-ja REAGON PËR SITUATËN E MBETURINAVE NË PRISHTINË: RREZIK SERIOZ PËR SHËNDETIN PUBLIK

PRISHTINË, 19 MAJ - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës (IKShPK) ka reaguar ndaj situatës alarmante të mbeturinave urbane në Prishtinë, duke theksuar rrezikun e ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit për shëndetin e qytetarëve. Sipas këtij instituti, kontejnerët e mbushur tej mase dhe hedhja e pakontrolluar e mbeturinave kanë krijuar mjedis të favorshëm për zhvillimin e baktereve dhe parazitëve, duke rritur rrezikun për sëmundje të tilla si dizenteria, hepatiti A dhe kolera.

“Menaxhimi i duhur i mbeturinave urbane është thelbësor për ruajtjen e një ambienti të pastër dhe për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve. Hedhja e pakontrolluar e mbeturinave ndikon drejtpërdrejt në ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit. Kjo situatë krijon kushte të favorshme për zhvillimin e baktereve, parazitëve dhe insekteve, duke rritur rrezikun për përhapjen e sëmundjeve infektive si dizenteria, hepatiti A, kolera dhe infeksionet e traktit respirator. Në aspektin mjedisor, mbeturinat kontribuojnë në ndotjen e tokës, ujërave dhe



ajrit, duke dëmtuar ekosistemet dhe biodiversitetin. Djegia e tyre e pakontrolluar çliron tym dhe gaze të dëmshme si dioksinat dhe furanet, të cilat mund të shkaktojnë sëmundje kronike të frymëmarrjes, alergji dhe, në raste të caktuara, edhe sëmundje kancerogjene. Nga

aspekti social, mungesa e menaxhimit të duhur të mbeturinave ndikon negativisht në cilësinë e jetës së qytetarëve, duke krijuar shqetësime në mjedisin ku ata jetojnë. Kjo situatë ishte veçanërisht e dukshme javën e kaluar në Prishtinë, ku

kontejnerët ishin të mbushur tej mase dhe mbeturinat ishin shpërndarë edhe jashtë tyre, për shkak të mosasgjësimit në kohë nga kompanitë përgjegjëse. Kjo paraqiste një rrezik serioz për shëndetin publik”, është thënë në reagimin e IKShPK-së, duke përmendur edhe rreziqet e tjera

nga mbeturinat. “Rrezik shtesë paraqesin edhe qentë dhe macet endacake, të cilët shpërndajnë mbeturinat, duke rritur mundësinë për përhapjen e sëmundjeve ngjitëse dhe krijuar zhurmë në lagjet e qytetit. Kapakët e kontejnerëve të hapur dhe kushtet klimatike me reshje shiu kanë favorizuar përhapjen e aromave të pakëndshme, duke ndikuar negativisht edhe në cilësinë e ajrit”, është thënë në këtë reagim.

IKShPK-ja ka rekomanduar: të bëhet largimi i rregullt i mbeturinave në çdo lagje të qytetit; të sigurohet funksionalizimi dhe mbyllja e kapakëve të kontejnerëve të mbeturinave; të pastrohet rregullisht hapësira përreth kontejnerëve; të rregullohet menaxhimi i mbetjeve inerte që nuk largohen nga kompania ‘Pastrimi’ dhe të ndalohet hedhja e materialeve ndërtimore dhe të ngjashme në pikat e grumbullimit të mbeturinave urbane, duke vendosur shenja të qarta ndaluese në secilën pikë grumbulluese. Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit publik, IKShPK-ja ka kërkuar që situata të tilla të mos përsëriten më.

SHKAKTUAN DËM MBI 412 MIJË EURO, AKTAKUZË NDAJ SHTATË ZYRTARËVE DHE NJË BIZNESMENI

PRIZREN, 19 MAJ - Departamenti i Krimeve të Rënda i Prokurorisë Themelore të Prizrenit ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve Xh. D., Y. G., Q. K., S. V., E. Sh., L. S., B. J., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” dhe D. N., për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale “Keqpërdorimi apo mashtrimi në prokurim publik”.

Në aktakuzë është thënë se më 4 gusht të vitit 2022 në kohë të pacaktuar në Prizren, të akuzuarit, në cilësinë e personave zyrtarë, për vlerësimin e ofertave në tenderin “Renovim dhe mirëmbajtje të objekteve të komunës së Prizrenit”, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre zyrtare, duke i mundësuar përfitim grupit të operatorit ekonomik “P.C.G. Sh.PK.” dhe “A.-T. Sh.PK.”. “Të pandehurit



veprojnë në kundërshtim me Ligjin për Prokurorim Publik dhe në kundërshtim me rregullat dhe udhëzuesin e prokurimit publik, në atë mënyrë që i akuzuari Xh. D., në cilësinë e kryetarit të komisionit vlerësues, Y. G. dhe Q. K., anëtarë të komisionit, i rekomandojnë autoritetit kontraktues - komunës së Prizrenit, lidhjen e kontratës në vlerë 550.000 euro, me grupin e operatorit të lartpërmendur, përkundër faktit që pesë

operatorë të përgjegjshëm që nuk janë rekomanduar nga komisioni vlerësues, kanë qenë më të lirë rreth 203.47 për qind, përkatësisht 202.771.98 euro sipas çmimeve mesatare të realizuar për tetë situacione deri më 05.08.2024”, është thënë në aktakuzë. Ndërsa i akuzuari S. V., menaxher i kontratës, e akuzuara L. S., mbikëqyrëse e brendshme dhe i akuzuari B. J., mbikëqyrës i jashtëm, gjatë ushtrimit të përgjegjësiave të tyre

nuk kanë vepruar konform legjislacionit të prokurimit dhe nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për ta parandaluar dëmin bërë autoritetit kontraktues lidhur me keqmenaxhimin e kontratës. I akuzuari E. Sh., në cilësinë e drejtorit të Administratës, mbikëqyrës i menaxherit të projektit, ka ndikuar që operatorët ekonomikë gjatë fazës së ofertimit të manipulojnë me çmime për njësi. “Të pandehurit e lartcekur nuk i kanë përmbushur detyrat e tyre dhe qëllimisht kanë mundësuar përfitim të dobisë pasurore për grupin e operatorit ekonomik ‘P.C.G. Sh.PK.’ dhe ‘A.-T.’ Sh.PK, duke shkaktuar dëm autoritetit kontraktues - komunës së Prizrenit, në vlerë prej 412.584.87 eurosh. Me këto veprime ata kanë kryer veprën penale ‘Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar’ sipas KPRK-së”, ka njoftuar Prokuroria Themelore e Prizrenit. Ndërsa i akuzuari D. N., në

cilësinë e personit përgjegjës të kompanisë “A.T. Sh.PK.”, Prizren, me vetëdije shkel rregullat e prokurimit publik, në atë mënyrë që paraqet dokumentacion të rremë sa iu përket çmimeve të para - masës dhe para - llogarisë, me ç’rast shumica e pozicioneve kanë pasur çmime jo normalisht të ulëta dhe çmime spekuluese, ku nga 233 pozicione, 74 pozicione nuk janë realizuar fare dhe qëllimi i uljes së çmimit në disa pozicione shumëfish nën çmimet e tregut, ka qenë fitimi i tenderit. Me këto veprime ai ka kryer veprën penale “Keqpërdorimi apo mashtrimi në prokurim publik”, sipas KPRK-së. Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre, të pandehurit e lartcekur për veprat penale për të cilat akuzohen të shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit.

Një foshnjë gjendet pa shenja jete në qese pranë një deponie në Prishtinë

PRISHTINË, 19 MAJ - Të hënën është gjetur një foshnjë e porsalindur brenda një qeseje afër një deponie të mbeturinave në Matiqan të Prishtinës. Lidhur me këtë çështje ka

folur Prokuroria Themelore në Prishtinë. Ky institucion ka bërë me dije se prokurori kujdestar është njoftuar për rastin dhe se po ndërmerrren të gjitha veprimet hetimore për çështjen në fjalë. “Ju

njoftojmë se prokurori kujdestar është njoftuar për rastin aktual dhe është në ndërmarrjen e të gjitha masave dhe veprimeve hetimore për këtë çështje”, kanë njoftuar nga

prokuroria. Ndërsa nga Policia e Kosovës kanë treguar se foshnja është gjetur e pajetë dhe është dërguar për obduksion në Institutin e Mjekësisë Ligjore.



LISTA SERBE KËRKON KOMPROMIS, KOSOVA VAZHDON T'I MBYLLË INSTITUCIONET E SERBISË



PRISHTINË, 19 MAJ - Derisa Lista Serbe u ka bërë thirrje vendeve të Quintit (Shteteve të Bashkuara, Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Italisë dhe Francës) të përfshihen në gjetjen e një zgjidhjeje kompromisi për funksionimin e ndërmarrjes Ujësllësi “Ibër”, autoritetet e Kosovës po vazhdojnë t'i mbyllin institucionet që funksionojnë sipas sistemit të Serbisë.

Më 16 maj është marrë nën kontroll objekti i Shërbimit Kombëtar të Punësimit në Mitrovicën e Veriut. Në ditët paraprahe janë mbyllur edhe hapësirat e palestrës sportive, muzeut të qytetit, Institutit për Kulturë, Rini, Sport dhe Shërbime të Specializuara, si dhe të Shoqatës Kulturore-Artistike Kosovski Bozhur.

Kryetari i Listës Serbe, Zllatan Ellek, ka deklaruar në një konferencë të jashtëzakonshme më 14 maj se partia e tij “është gjithmonë për një zgjidhje kompromisi” që duhet kërkuar përmes bisedimeve dhe dialogut. “Për fat të keq, nuk kemi me kë të bisedojmë, sepse dialogu me autoritetet në Prishtinë nuk ekziston – ata e refuzojnë”, ka thënë kreu i partisë më të madhe të serbëve të Kosovës që mbështetet nga Beogradi.

Ky është rasti i parë që Lista Serbe ka kërkuar një kompromis për

mbylljen e institucioneve serbe të cilat autoritetet e Kosovës i konsiderojnë si paralele dhe ilegale dhe të cilat kanë nisur të mbylljen në fillimin e vitit 2024. Qeveria e Kosovës nuk i është përgjigjur pyetjes së “Radios Evropa e Lirë (REL)” nëse aktualisht ekziston gatishmëri për dialog mbi funksionimin e mëtejshëm të institucioneve të financuara nga Beogradi.

Çfarë nënkuptohet me zgjidhje kompromisi?

Delegacioni i Listës Serbe më 15 maj, në një takim me përfaqësues të Ambasadës së ShBA-së në Prishtinë, ka shprehur shqetësim për valën e re të mbylljes së institucioneve serbe nga autoritetet e Kosovës. Sipas njoftimit të kësaj partie, ata kanë paraqitur “propozime konkrete për tejkalimin e situatës së krijuar”, që përfshijnë, ndër të tjera, kthimin e menjëhershëm të të gjithë punonjësve në vendet e tyre të punës në kompaninë serbe Ujësllësi “Ibër”.

“REL”-i i është drejtuar Listës Serbe për sqarime rreth natyrës së këtyre propozimeve kompromisi dhe nëse ato përfshijnë edhe institucionet e tjera të mbyllura, por nuk mori përgjigje.

Ndërkohë, i ashtuquajturi drejtor

i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, ka zhvilluar takim me ambasadorët e vendeve të Quintit në Beograd, ku ka theksuar se “tema prioritare në dialogun me Prishtinën duhet të jetë shtensionimi” dhe se “për këtë duhet të fillojë diskutimi”. Ai u ka bërë thirrje Bashkimit Evropian (BE) dhe vendeve të Quintit që të angazhohen “për ta ndalur dhunën e Albin Kurtit ndaj serbëve dhe institucioneve serbe”.

“Thirrje e vonuar për kompromis”

Politologu nga Prishtina, Dritëro Arifi, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se kërkesa e Listës Serbe për kompromis është e vonuar dhe se kjo parti duhej ta kishte adresuar më herët, përpara se ta niste bojkotin e institucioneve të Kosovës në vitin 2022. Ai ka thënë se Lista Serbe e ka humbur kredibilitetin pas bojkotit të zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës në vitet 2023 dhe 2024 dhe se realiteti në terren ka ndryshuar.

“Kjo çështje (e mbylljes së institucioneve serbe) lidhet më shumë me dialogun Kosovë - Serbi dhe me zbatimin e marrëveshjes së Brukselit. Por, në fund të fundit, pa marrëveshje përfundimtare dhe njohje

reciproke, nuk do të ketë dialog real në këtë kuptim”, ka thënë Arifi.

Ndërsa politologu nga Beogradi, Ognjen Gogiq, ka vlerësuar se për autoritetet e Kosovës nuk është në interes të ndërpriten shërbimet e ndërmarrjeve komunale dhe beson se do të gjendet një zgjidhje për funksionimin e tyre. Megjithatë, sipas tij, kjo nuk do të jetë e mundur për institucione të tjera serbe që ekzistojnë paralelisht me ato të Kosovës, si komunat, qendrat për punë sociale e të tjera.

“Varet nëse ato institucione janë të nevojshme për Kosovën. Për ato që janë të nevojshme, është e pashmangshme të gjendet një zgjidhje”, ka thënë Gogiq. Ndërkohë ndërmarrja publike komunale në Shtërpçë - komunë me shumicë serbe në jug të Kosovës - ka rifilluar punën brenda sistemit të Kosovës pasi ishte mbyllur në fillim të majit.

Protesta dhe reagime ndërkombëtare

Anëtarë të klubeve sportive që përdornin hapësirat e palestrës së mbyllur kanë protestuar të premten në Mitrovicën e Veriut, duke kërkuar që ajo t'u kthehet e t'i vazhdojnë aktivitetet. Në protestë morën pjesë edhe disa

anëtarë të Listës Serbe. Të rinjtë, shumica prej të cilëve ishin të shoqëruar nga prindërit, kanë thënë se “po u mohohet e drejta për të ushtruar sport dhe aktivitete”. Nga komuna e Mitrovicës së Veriut kanë thënë se palestra është funksionale dhe se të interesuarit për ta përdorur duhet t'u drejtohen personave përgjegjës për caktimin e orareve. Megjithatë, Bashkimi Evropian reagoi më 16 maj, duke vlerësuar se veprimet e autoriteteve të Kosovës rrezikojnë ngritjen e tensioneve në terren dhe ndikojnë negativisht në jetën e përditshme të komuniteteve lokale dhe në imazhin ndërkombëtar të Kosovës.

BE-ja, po ashtu, u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë ta zbatojnë marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të marrëdhënieve, të pranuar nga të dyja palët në vitin 2023, dhe që ta fillojnë menjëherë zbatimin pa vonesa apo kushte të të gjitha marrëveshjeve të arritura.

“Kjo përfshin krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Normalizimi i marrëdhënieve është kusht thelbësor për rrugën evropiane të të dyja palëve”, është thënë në reagim.

Ky asociacion ishte parashikuar të rrugësojë, ndër të tjera, funksionimin e institucioneve serbe, pagesat dhe financimet nga buxheti i Serbisë.

Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guerot, më 15 maj ka përsëritur se çështja e mbylljes së institucioneve serbe duhet të trajtohet në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve çka, sipas autoriteteve në Prishtinë, është e papranueshme, pasi ata theksojnë se po vendosin rend, ligj dhe sundim të ligjit. Beogradi, në anën tjetër, refuzon t'i mbyllë institucionet në Kosovë. Disa prej tyre i ka zhvendosur në qytetet kufitare brenda territorit të Serbisë, ndërsa ka vazhduar t'i paguajë pagat mujore për të punësuarit.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë reagoi, duke paralajmëruar se mbyllja e institucioneve serbe pa një tranzicion institucional, pa alternativa të qëndrueshme dhe pa përfshirjen e komunitetit lokal, “rrezikon seriozisht qasjen e komuniteteve joshumicë në shërbimet bazë”.

“Ambasadorja” amerikane viziton veriun: Qeveria t'i sigurojë qytetarët të jetojnë në mënyrë paqësore

PRISHTINË, 19 MAJ - Pas zhvillimeve të fundit në veri të vendit pas mbylljes së disa zyrave të strukturave paralele serbe, e ngarkuara me punë në ambasadën amerikane në Kosovë, Anu Prattipati, ka qëndruar në veri. Ajo është takuar me politikanë lokalë atje. Në njoftimin e

Ambasadës së ShBA-së është thënë se Qeveria e Kosovës duhet t'i sigurojë qytetarët që të jetojnë në mënyrë paqësore. “E ngarkuara me punë, Anu Prattipati, pati sot një vizitë produktive në veri të Kosovës, ku u takua me liderë të shoqërisë civile, përfaqësues politikë dhe Policinë e

Kosovës. CDA përsëriti qëndrimin e Qeverisë së ShBA-së: stabiliteti dhe siguria janë kyçe. Është përgjegjësi e Qeverisë së Kosovës që të sigurojë që të gjithë qytetarët të jetojnë në mënyrë paqësore”, ka njoftuar Ambasada e ShBA-së në Kosovë.



AUTORITETI I KONKURRENCËS PO HETON TREGUN E BUKËS DHE GASTRONOMISË

PRISHTINË, 19 MAJ - Autoriteti i Konkurrencës i Kosovës (AKK) ka nisur një hetim për monitorimin e tregut vendor, pas shqetësimeve të qytetarëve dhe raportimeve në medie për rritje të çmimeve për produktet e shportës bazë: bukës, kafesë dhe produkteve të tjera. Në këtë drejtim, AKK-ja është duke zhvilluar një analizë të thelluar për mbi njëzet produkte ushqimore në tregun e Kosovës, për t'i identifikuar arsyet reale të rritjeve të çmimeve. Ushtruesi i detyrës së shefit të Departamentit të Analizës dhe Metodologjisë në AKK, Adrian Mustafa, ka thënë për "Kosovapress" se një vëmendje të veçantë është duke iu kushtuar sektorit të bukës dhe gastronomisë, ku çmimi i kafesë ka shënuar rritje të konsiderueshme. Mustafa ka bërë me dije se nëse gjatë analizës identifikohen shkelje të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, AKK-ja do të ndërmarrë masa



ligjore në përputhje me kompetencat që ka. "Për shkak të shqetësimeve të ngritura nga qytetarët e Republikës së Kosovës dhe raportimeve të shumta në medie, Autoriteti ka shtuar aktivitetet për monitorimin e tregjeve ku ka

shqetësime. Aktualisht është duke u zhvilluar një analizë e thelluar e mbi 20 produkteve ushqimore. Do të thotë, produkteve bazë ushqimore për t'i analizuar edhe arsyet e ngritjes së çmimit të tyre. Gjithashtu, në kuadër të

shqetësimeve që i kemi pranuar, ka filluar edhe monitorimi i tregut të bukës, ku AKK-ja është në proces të mbledhjes së informatave për të vlerësuar nëse rritjet e çmimit të produkteve, në këtë rast të bukës në këtë sektor, janë të arsyetu-

ara apo në kundërshtim me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës. Në kuadër të kësaj, përpos bukës, kemi filluar monitorimin e tregut. Është një monitorim edhe në produktin e kafesë. E kemi pasur një shqetësim në sektorin e gastronomisë, me theks të veçantë në rritjen e çmimit të kafesë. Inspektorët e Autoritetit çdo ditë janë në terren dhe po zhvillojnë në qytete të ndryshme intervista dhe po mbledhin të dhëna prej ndërmarrjeve për arsyet e ngritjes së këtyre çmimeve", ka thënë Mustafa, duke shtuar se AKK-ja nuk ka mandat për të ulur apo përcaktuar çmime por, sipas tij, është përgjegjëse për të ndërhyrë kur këto çmime vendosen në mënyrë të paligjshme apo të bashkërenduar. Rritja prej 16.1-përqindësh e çmimit të energjisë elektrike në Kosovë ka shkaktuar një valë të re të inflacionit, duke ndikuar në ngritje të çmimeve për produktet bazë të vendit.

KOMUNA E PRISHTINËS, KONTRATË 1.5-MILIONËSHE ME 'PASTRIMIN' PËR PUNË SHITESË

PRISHTINË, 19 MAJ - Drejtori i Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, Bekim Brestovci, pas takimit me përfaqësuesit e Sindikatës së Ndërmarrjes "Pastrimi", ka njoftuar se është arritur marrëveshja për nënshkrimin e një kontrate në vlerë prej 1.5 milion eurosh për punë shtesë të kësaj ndërmarrjeje. Ai ka theksuar se nëse krijohen kushtet, "Pastrimi" do të marrë përsipër 1/3 e regionit të Prishtinës, duke e shtuar kapacitetin operativ krahas dy operatorëve ekzistues. Brestovci ka thënë se komuna e Prishtinës është e gatshme të thërrasë një seancë të jashtëzakonshme për të diskutuar subvencionimin e pagave për punëtorët. "Jemi dakorduar që nga sot, me një person të autorizuar nga ndërmarrja 'Pastrimi', ta nënshkruajmë kontratën prej 1.5 milion eurosh për punën shtesë. Ne u dakorduam



që nëse krijohen kushtet nga ndërmarrja 'Pastrimi' dhe ka mundësi të dalë e të operojë

për ta kryer shërbimin, ta ketë 1/3 e regionit të Prishtinës, sepse aktualisht kemi vetëm dy

operatorë ekonomikë. Nga ana jonë nuk ka asnjë hezitim. Ne shprehëm gatishmërinë që të

thërrasim një seancë të jashtëzakonshme për ta sjellë sërish vendimin për subvencionimin e pagave për punëtorët. Natyrisht, duhet të punojmë bashkërisht", ka thënë Brestovci. Para arritjes së kësaj marrëveshje, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur në takim përfaqësuesit e Sindikatës së Ndërmarrjes "Pastrimi" pas situatës së rëndë të krijuar në kryeqytet për shkak mosheqjes së mbeturinave disa ditë, ku ka ngjallur pakënaqësi të mëdha te qytetarët. Rama ka thënë se punëtorët nuk janë fajtorë për situatën e krijuar dhe ka theksuar se problemi qëndron te menaxhmenti i ndërmarrjes që, sipas tij, nuk ka ditur t'i menaxhojë proceset. Ndërsa përfaqësuesit e Sindikatës së Ndërmarrjes "Pastrimi" kanë kërkuar të mos dëmtohen punëtorët.

Punëtorët e "Infrakos"-it dhe të "Trainkos"-it protestojnë për rritje pagash, paralajmërojnë "bllokadë totale"

PRISHTINË, 19 MAJ - Për një orë treni në stacionin hekurudhor në Fushë-Kosovë ka ndaluar së funksionuari për shkak të një proteste të organizuar nga punëtorët e kompanive publike "Infrakos" dhe "Trainkos". Kjo është hera e dytë që punonjësit protestojnë, duke kërkuar rritje të pagave, të cilat, sipas tyre, nuk janë ndryshuar për më shumë se 15 vjet.

Kryetari i Sindikatës së "Infrakos"-it, Hysen Nikçi, ka deklaruar se kërkesa e vetme është rritja e pagave, dhe se ky veprim simbolik është një paralajmërim i fundit për institucionet përgjegjëse, para hyrjes në grevë nga 26 maji, në rast se kërkesat nuk plotësohen. "Sot është protesta e dytë. Protestojnë 'Trainkos' dhe 'Infrakos' për ngritjen e pagave. Sot jemi

mbledhur për t'i bërë thirrje edhe bordit edhe qeverisë t'i rregullojnë çështje tona. Të dy kompanitë kërkojmë rritjen e pagave. Kjo është protesta e dytë që nuk ka dhënë rezultat. Protestën sot e kemi bërë një orë, se ndoshta iu shkon në vesh më shumë. Kanë një javë të reflektojnë. Nëse jo, nga e hëna do të ketë bllokadë totale", ka deklaruar Nikçi.



KODI KOZMIK: A JANË PIRAMIDAT E EGJIPTIT MESAZHE NGA UNIVERSI?

Kodi i Humbur i Universit: Çfarë fshehin vërtet Piramidat e Egjiptit?



Simbole, numra dhe përputhje të frikshme me ligjet e natyrës – një mesazh i lashtë nga yjet apo thjesht një rastësi që nuk mund ta shpjegojmë? Nga numri π te shpejtësia e dritës, përputhjet janë tronditëse – rastësi apo provë që egjiptianët e lashtë dinin diçka që ne ende nuk e kuptojmë?

Të gjithëve na pëlqejnë nga pak teoritë që të bëjnë të vësh gjithçka në dyshim. Dhe pak teori ngjallin më shumë kuri-ozitet — dhe debat — sesa Kodi Kozmik: një koncept që sugjeron se universi, matematika dhe madje edhe monumente të lashta si Piramidat e Egjiptit mund të jenë të lidhura përmes modeleve dhe dijes së fshehur. Disa e quajnë një lojë me numra. Të tjerë e shohin si një plan të koduar të universit, që formëson historinë dhe madje jep sinjale për atë që do të ndodhë.

Origjina e kodit kozmik

Fizikani Heinz R. Pagels përdori për herë të parë shprehjen “Kodi Kozmik” në librin e tij të vitit 1982 “The Cosmic Code: Quantum Physics as the Language of Nature”. Vepra e tij trajtonte bazat e fizikës dhe mekanikës kuantike, duke theksuar kontributet e Albert Einstein, Max Planck dhe John Stewart Bell. Puna e Pagels ishte tërësisht e

bazuar në shkencë, jo në histori të lashtë apo njohuri të fshehta. Por me kalimin e kohës, ideja e një “kodi” të fshehur në univers mori jetë më vete.

Piramidat dhe kodi kozmik

Piramida e Madhe e Gizës është një nga strukturat më të studi-uara në histori. Ashtu si monu-mente të tjera historike si Stonehenge, sa më thellë e shqyrtojnë ekspertët projektin e saj, aq më të çuditshme duken detajet. Ja disa nga teoritë që ka frymëzuar Kodi Kozmik:

Piramida dhe numri π (pi)

Përmasat e piramidës janë çuditërisht afër për të koduar numrin π (pi), një konstante themelore në matematikë. Nëse ndahet perimetri me lartësinë, rezultati i afrohet 2π . Disa besojnë se kjo tregon njohuri të avancuara në gjeometri, shumë përtej kohës së tyre. Të

tjerë argumentojnë se është thjesht rastësi inxhinierike praktike.

Piramida dhe shpejtësia e dritës

Një nga pretendimet më kontroverse në lidhje me Kodin Kozmik është se madhësitë e Piramidës së Madhe përputhen me shpejtësinë e dritës. Gjerësia gjeografike e Piramidës është 29.9792458°N . Gjatësia e korridoreve dhe dhomave në piramidë raportohet si 29–97–92–45–8 metra. Shpejtësia e dritës është 299,792,458 metra për sekondë në vakum. Rastësi? Me shumë gjasë po. Sistemi metrik u krijua në shekullin XVIII, shumë kohë pasi ishin ndërtuar piramidat. Që egjiptianët e lashtë ta kishin koduar këtë numër, do të duhej të parashikonin njësitë moderne të matjes mijëra vjet përpara.

Lidhja me yjësinë Orion

Disa studiues pretendojnë se piramidat në Giza përputhen me yjësinë “Rripi i Orionit”. Dihet që egjiptianët e lashtë ndiqnin qiellin e natës, studionin yjësitë dhe i përdornin lëvizjet e yjeve për të marrë vendime në bujqësi. Kjo ka bërë që disa të mendojnë se edhe piramidat u ndërtuan

sipas një plani “kozmetik”. Teori interesante, pa dyshim. Por shumë arkeologë hedhin poshtë këtë pretendim, pasi përputhja nuk është e saktë, dhe shumë formacione natyrore mund të duken si modele qiellore në retrospektivë.

Një lidhje me jashtëtokësorët?

Zecharia Sitchin, një autor i apasionuar pas qytetërimeve të lashta, e çoi idenë e Kodit Kozmik edhe më tej. Në libra si “The Earth Chronicles”, ai pretendon se shoqëritë e hershme kishin zbuluar njohuri të fshehura shumë përpara shkencës moderne. Sipas Sitchin, jashtëtokësorë zbarkuan në Tokë për të nxjerrë ar. Por në vend që ta nxirrnin vetë, modifikuan gjenetika krijet tokësore dhe ua lanë këtë detyrë atyre. Këto njohuri, sipas tij, u koduan në monumente, në gjeometri të shenjtë dhe madje në tekste fetare. Ai pretendon se provën e kemi përpara syve tanë: veçanërisht piramidat egjiptiane ndjekin modele matematikore shumë të sakta për të qenë rastësi.

Kodi Kozmik: shkencë apo spekulim?

Jo të gjithë besojnë se piramidat përmbajnë mesazhe të fshehta. Shumica e histori-

anëve mendojnë se qytetërimet e lashta mbështeteshin në eksperiencë praktike dhe mjeshtëri inxhinierike – jo në plane të koduara nga universi.

Megjithatë, disa pyetje mbeten pa përgjigje: Si arritën egjiptianët saktësi të tillë pa mjete moderne? Pse ka kaq shumë vende të shenjta në botë që përputhen me modele qiellore? A po shohim projekt të qëllimshëm — apo thjesht po shohim modele aty ku duam t'i shohim? Edhe nëse Kodi Kozmik nuk është real, modelet ekzistojnë në natyrë. Rendi Fibonacci shfaqet në lule, galaktikat rrotullohen sipas formave të parashikueshme, dhe ligjet e fizikës ndjekin rregulla matematikore. Ndoshta ndërtuesit e lashtë reflektuan në mënyrë të pavetëdijshme këto modele universale në veprat e tyre? Pra, a ka një gjuhë të fshehur të universit të koduar në monumentet e lashta? Apo thjesht jemi të zotë në zbulimin e modeleve dhe në dhënien e kuptimit aty ku nuk ka? Për momentin, Kodi Kozmik mbetet njëherazi fakt shkencor dhe mister i hapur. Dhe pikërisht kjo e bën kaq magjepsës. Qoftë urtësi i lashtë apo rastësi e pastër — një gjë është e sigurt: historia ende ka sekrete që presin të zbulohen. / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Valon Bunjaku, MVP i ndeshjes Bashkimi - Trepça

Basketbollisti Valon Bunjaku është zgjedhur MVP i ndeshjes Bashkimi - Trepça. Bashkimi të dielën mbrëma mundi Trepçën me rezultat 85-

77 në finalen e pestë të "play-off"-it të Superligës së Kosovës në basketboll. "Votuesit në Rrjetet Sociale të FBK-së kanë zgjedhur Valon Bunjakun MVP i

ndeshjes Bashkimi - Trepça", thuhet në njoftimin e Federatës së Basketbollit të Kosovës. Bunjaku ndaj mitrovicasve kishte 15 pikë, shtatë kërcime e

gjashtë asistime, duke arritur indeksin 22. Ndeshja e gjashtë e finales zhvillohet të enjten në orën 19:00. Nëse Trepça fiton, atëherë shpallet kampione e

Superligës së Kosovës, ndërsa nëse Bashkimi arrin ta barazojë serinë në 3-3, gjithçka do të vendoset në ndeshjen e shtatë.

Kongresi më i madh i FIBA-s, Fetahu paraqet përvojën dhe sukseset e FBK-së

PRISHTINË, 19 MAJ - Kongresi më i madh i FIBA-s është mbajtur në Bahrein, me më shumë se 350 të ftuar, ku ishin 167 delegatë, rekord i pjesëmarrjes nga Federatat Kombëtare. Në këtë Kongres më 16 dhe 17 maj kanë marrë pjesë edhe kryetari i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Arben Fetahu dhe sekretarësja e përgjithshme e FBK-s, Elvira Dushku. Kryetari Arben Fetahu ka mbajtur paraqitje të veçantë në Kongresin e FIBA Botës, ku ndau me komunitetin global përvojën dhe sukseset e FBK-së në hartimin dhe zbatimin e Planit Strategjik 2021-2025, në partneritet me FIBA-n. Për herë të parë Federata e Basketbollit e Kosovës është ftuar të prezantojë në një ngjarje të këtij niveli si model suksesi në planifikim strategjik, një moment jashtëzakonisht i rëndësishëm për sportin në Kosovë.

Pjesëmarrja e FBK-së me këtë prezantim të suksesshëm është një dëshmi e qartë e reputacionit në rritje të Kosovës në arenën ndërkombëtare të basketbollit si dhe e përkushtimit tonë për një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të sportit. Presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (KON), Thomas Bach, kontribuoi me fjalë përshëndetëse përmes një videoje, ndjekur nga një fjalim nga presidenti i FIBA-s, Sheikh Saud Ali Al Thani.

Sekretari i përgjithshëm i FIBA-s, Andreas Zagklis, para delegatëve dha një përditësim mbi strategjinë e FIBA-s për ciklin aktual, duke vazhduar temën e nënvizimit të popullaritetit në rritje të sportit. Kjo përfshinte suksesin dhe ekspozimin që gëzonte në drejtimin përpara dhe në Lojërat Olimpike Paris 2024 - si dhe rritjen tërheqëse të lojës së femrave. Ndërkohë, për herë të parë 14 trofe të garave të FIBA-s u ekspozuan në këtë ngjarje dhe koleksioni mbresëlënës i argjendit nënvizoi natyrën globale të sportit dhe rëndësinë e kupave të ndryshme



kontinentale dhe kupave botërore U19 të këtij viti. Një sërë ndryshimesh në statutin e përgjithshëm të FIBA-s u miratuan nga Kongresi. Më pas, delegatët mund të mësonin më shumë për shërbimet e reja që janë aktualisht në dispozicion për Federatat Kombëtare dhe u njohën me disa iniciativa të mëdha, duke përfshirë nisjen zyrtare të Akademisë FIBA, transformimin digjital të FIBA-s, zgjerimin e e FIBA-s dhe prezantimin e zgjidhjeve të fuqizuara nga AI për menaxhimin e aseteve digjitale dhe mediatike. Përfaqësuesit e 167 federatave kombëtare u përfshinë në seancat e shumta të ditës së dytë. Kjo pasoi me mësimin e rreth një sërë shërbimesh të reja për federatat kombëtare në ditën e parë të kongresit. E shpallur si zona numër një e rritjes për sportin dhe gjithashtu një nga prioritetet strategjike të FIBA-s, pati një seancë të dedikuar zhbllokimit të fuqisë së basketbollit të femrave. Kjo u përshtat rreth rëndësisë së integritetit global dhe një angazhimi për

fuqizimin e individëve si brenda dhe jashtë fushës. Me një fokus në angazhimin e tifozëve dhe rolin kryesor që luajnë federatat kombëtare, sesioni theksoi strategjitë vepruese për ta ngritur më tej lëvizjen e basketbollit të grave në mbarë botën. Pati, gjithashtu, një seancë për FIBA Plus, e cila po ndihmon në formësimin e së ardhmes së sportit në kapacitetin e tij si ombrellë për të gjitha nismat e zhvillimit të federatës kombëtare. Seancat u ofruan pjesëmarrësve një përmbledhje të plotë të programeve të dizajnuara për t'i përmbushur nevojat specifike të federatave kombëtare, të plotësuar me njohuri nga Federata e Basketbollit e Kosovës, të cilët ndanë përvojën e tyre të drejtpërdrejtë me iniciativën. Aktivitete të tjera u zhvilluan në lidhje me qasjen dhe përfitimin nga fondet e Solidaritetit Olimpik, si dhe të kuptuarit e zhvillimeve të NCAA-s në kompensimin e lojtarëve, veçanërisht ndikimet mbi palët e interesuara të FIBA-s dhe rekomandimet për të ardhmen.

SHKURT

Napoli bën ofertë për Zhegrovën

Reprezentuesi i Kosovës, Edon Zhegrova, pritet të largohet nga Lille gjatë kësaj vere dhe shumë skuadra të njohura të Evropës kanë shprehur interesim për shërbimet e tij. Mediet në Francë të hënën kanë raportuar se Napoli tashmë ka kontaktuar Lillen dhe ka bërë ofertë zyrtare për sulmuesin e krahut. Oferta e Napolit është vlerësuar tejet e ulët nga Lille, pasi ekipi italian për transferimin e Zhegrovës ka ofruar 10 milionë euro. Zhegrova ka kontratë me Lillen deri në vitin 2026 dhe ekipi francez për kartonin e tij po kërkon të paktën 20 milionë euro. 26-vjeçari nuk ka luajtur për më shumë se pesë muaj për shkak të lëndimit, ndërsa këtë sezon ka shënuar 8 gola dhe ka bërë 2 asistime në 21 ndeshje.

Ramadani, 'hero' i Lecces: Të gjithë së bashku në Romë

Ylber Ramadani ka qenë protagonist te Lecce. Ylli nga Kosova e shënoi një gol spektakolar në fitoren me rezultat 1-0 ndaj Torinos. Përfaqësuesi shqiptar shënoi sapo filloi pjesa e dytë dhe ky mund të jetë goli i shpëtimit për ekipin kuq e verdhë. Ish-futbollisti i Ferizajt ia mundësoi Lecces që t'u shmanget pozitave që çojnë në Serinë B, një xhiro pa përfunduar sezonin në Serinë A. "Një fitore e rëndësishme, i lumtur për këtë gol. Të gjithë së bashku në Romë. Forza Lecce!", ka shkruar Ramadani. Në xhiron e fundit Ramadani me shokë do ta vizitojnë Lazion me synim të fitores së madhe për ta siguruar mbetjen në ligën elitare italiane.

Manaj kundër trajnerit: Nuk isha i lënduar, mund të luaja

Rey Manaj mungoi në ndeshjen e fundit të kampionatit turk, me trajnerin e Sivassporit, Calimbay, që theksoi se sulmuesi shqiptar ishte i lënduar. Nuk ka "qëndruar

duarkryq" vetë Manaj, i cili ka reaguar, duke thënë se diçka e tillë nuk është e vërtetë. Sipas tij, ky vendim ka qenë i trajnerit. "Edhe pse kam dy muaj që luaj i

dëmtuar, kam dhënë më të mirën. U stërvita me ekipin dy ditë para ndeshjes. Isha gati të luaja edhe si zëvendësues. Trajneri gjeti një justifikim për të më lënë jashtë,

diçka që e kishte planifikuar më parë. Më lajmëroi me mesazh se nuk do të më grumbullonte. Ego personale duhet të lihet mënjanë për të mirën e ekipit, por rezultatet

kanë treguar se trajneri vendos gjithmonë egon përpara çdo gjëje", ka thënë Manaj. Kujtojmë që Sivasspori ka rënë nga kategoria.

Hamiltoni: Nuk e prisja vendin e katërt, me disa xhiro më shumë mund të kapnim podiumin

IMOLA, 19 MAJ - Pas provave zyrtare të së shtunës, ku Ferrari zhgënjeu me të dy pilotët e saj, gara e së dielës në Imola ishte më e mirë për "kokëkuqen". Strategjia, menaxhimi i gomave dhe hyrja e makinës së sigurisë u dhanë një dorë pilotëve të Ferrari. Lewis Hamiltoni, që e nisi garën nga vendi i 12, e përfundoi atë

në vendin e katërt. Një rezultat, që siç konfirmon piloti britanik, shtatë herë kampion bote në Formula 1, nuk e priste aspak pas problemeve që hasën ditën e shtunë. "Jam shumë i lumtur. Shpirti i Imolas është i jashtëzakonshëm. Faleminderit të gjithëve! Nuk dija çfarë të prisja dhe duhet të them që ishte e veçantë për mua kur pashë

këtë 'det të kuq'. Mendoj se ishte një nga vitet me audiencën më të madhe dhe entuziazmin më të madh. Ishte një flamur i madh i Ferrarit që më kujtoi vitet e Schumacherit. Sa i përket garës, nuk e prisja vendin e katërt, por makina më dha ndjenja të mëdha. Skuadra bëri një punë fantastike. Po arrijmë ngadalë atje ku duam. Mendoj

se pas kësaj gare mund të mendojmë për fitore", ka thënë Hamiltoni. "Me inxhinierin tim Riccardo Adami bëmë një punë të mirë në nivelin e komunikimit. Qëndruam të dy të qetë. Punë e shkëlqyer ekipore dhe ekzekutim i shkëlqyer. Më duheshin edhe disa xhiro për të shkuar në gjueti për podiumin", ka deklaruar Hamiltoni.



Kololli: Nuk doja të qëndroja te Baseli edhe pse u bë kampion

BASEL, 19 MAJ - Bernjamin Kololli po kalon një formë të jashtëzakonshme në Superligën e Zvicrës. Shqiptari ka qenë një nga emrat më të përfolur në këtë pjesë të dytë të sezonit, pas rikthimit të tij në janar te skuadra e Sionit. Me nëntë gola të shënuara deri më tani, një për Baselin dhe tetë për Sionin, Kololli ka tërhequr vëmendjen për efikasitetin e tij. Ai ka luajtur vetëm 963 minuta për Sionin dhe 155 minuta për Baselin, por ka arritur të realizojë një gol çdo 120 minuta për ekipin aktual, sipas statistikave të publikuara nga "Blick". Krahastuar me të, Xherdan Shaqiri, lider i golashënuesve me 18 finalizime, shënon një herë çdo 140 minuta. Në këtë renditje të veçantë të efikasitetit, më mirë se Kololli është vetëm Philipp Otele i Baselit, i cili gjuan në rjetë çdo 117 minuta. Forma e tij e lartë u konfirmua edhe në fundjavë, kur



realizoi dy gola në fitoren 2:1 të Sionit kundër Grassopperit, duke e ndihmuar skuadrën të ngjitet në vendin e nëntë me 44 pikë. Për "Blick", Kololli u shpreh i kënaqur me atë që ka arritur edhe pse ka mundur ta fitojë titullin kampion me Baselin. "Jo keq, apo jo? Jam i kënaqur. Shumë njerëz më thanë se do të ishte kampion me Baselin nëse do të kishte qëndruar, por për mua është ndryshe. Nuk luaja më atje. Dhe

nëse do të isha bërë kampion në atë mënyrë, pa luajtur, nuk do të ndihesha kampion i vërtetë". "Por këtu gjithçka po shkon në mënyrë të shkëlqyer. Nuk do ta kisha menduar kurrë këtë gjashtë muaj më parë", deklaroi Kololli. Renditja e golashënuesve aktualisht kryesohet nga Xherdan Shaqiri me 18 gola, i ndjekur nga Dereck Kutesa (15) dhe Willem Geubbels (14), ndërsa Kololli renditet i katërti me 9 gola.

Oklahoma siguron kualifikimin në finale

OKLAHOMA, 19 MAJ - Oklahoma është skuadra e dytë finaliste e "play-off"-it në Konferencën e Perëndimit. Ekipi me rekordin më të mirë të sezonit të rregullt ia doli të kualifikohej pas fitoi gjysmëfinalen e shtatë ndaj Denverit, 125-93. Një përballje që nuk pati shumë histori, pasi Oklahoma nuk zhgënjeu para fansave, duke e merituar fitoren. Thunderi fitoi 4-3 serinë e takimeve ndaj Nuggetsit, që largohet kokëllartë nga kjo përballje. Alexander Shai ishte ai që bëri dallimin në fushë për Oklahomën, autor i 35 pikëve, ndërkohë që 37 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. Për miqtë, Jokici realizoi 20 pikë, por që nuk mjaftuan për të fituar. Ndeshja pati histori vetëm në periudhën e parë, aty ku Nuggetsit arriti t'i mbyllë 12 minutat e parë në



avantazh 26-21. Por kthesa për vendasit do të niste që në periudhën e dytë aty ku Oklahoma arriti të fitonte me dallim prej 19 pikësh, avantazh i cili u ruajt edhe në dy periudat e dyta, duke çuar Oklahoman drejt finales së Konferencës së Perëndimit aty ku do ta sfidojë

Minesoran. Kujtojmë që në Konferencën e Lindjes, New York, pasi eliminoi kampionët në fuqi të Boston Celticsit, do ta sfidojë surprizën e këtij sezoni, Indianën. Seria e finaleve në Perëndim do të nisë të mërkurën e 21 majit, ndërsa ajo e Lindjes një ditë më pas.

SHKURT

Messi nuk e zbulon të ardhmen e vet

Pas humbjes së Inter Miamit në shtëpi ndaj Orlando Cityt, Lionel Messi u përball me pyetjen për të cilën shumë tifozë presin një përgjigje: çfarë do të ndodhë me të pas përfundimit të kontratës në dhjetor? Megjithëse e ardhmja e tij mbetet një mister, e vetmja gjë e sigurt është se argjentinasi do të marrë pjesë në Botërorin e Klubeve, që do të zhvillohet më vonë gjatë vitit. Pas ndeshjes, një gazetar u përpoq të nxirrte ndonjë informacion duke i bërë një pyetje të drejtpërdrejtë: "Ka ndonjë lajm për rinovimin tënd?". Messi, me një buzëqeshje karakteristike, shmangu përgjigjen duke thënë shkurt: "Jo, jo... për këtë jo". Kjo përgjigje e shkurtër vetëm sa shton misterin rreth të ardhmes së kampionit botëror, i cili për momentin nuk ka dhënë asnjë sinjal për vendimin që do të marrë në fund të vitit.

Bayerni, afër marrëveshjes me mbrojtësin Tah

Mbrojtësi gjerman Jonathan Tah është një nga lojtarët më të lakmuar në tregun e ardhshëm të transferimeve si "parametër zero" dhe, sipas gazetarit të njohur Fabrizioo Romano, është Bayern Munichu ai që kryeson garën për firmën e tij. Pas përfundimit të kontratës me Bayer Leverkusenin, Tah ka marrë një ofertë konkrete nga kampionët e Gjermanisë, të cilët shpresojnë ta mbyllin sa më shpejt transferimin e 28-vjeçarit. Më herët Barcelona ishte shumë pranë sigurimit të mbrojtësve të tij, por klubi katalanas nuk e finalizoi kurrë në mënyrë përfundimtare marrëveshjen. Transferimi i Tah në Bayern do ta përforconte ndjeshëm repartin defensiv të ekipit dhe do të ishte një tjetër lëvizje strategjike për një sezon të ri që kërkon rikthimin në majat e futbollit evropian.

Mesfushori i Villarrealit: Yamal është më i mirë se Messi

Pape Gueye, mesfushori i Villarrealit ka treguar se çfarë thoshin lojtarët e skuadrës së tij për Lamine Yamal pas përballjes me të në fushë. Ai u shpreh i mahnitur nga paraqitja e 17-vjeçarit të Barcelonës, duke theksuar nivelin e lartë të pjekurisë që Yamal shfaq në fushë. "Tani për tani, Lamine Yamal është ai që krijon lojën për Barçën dhe kjo në moshën vetëm 17-vjeçare!", ka thënë Gueye. Sipas tij, ishte jashtëzakonisht e vështirë të ndalohej Yamal gjatë ndeshjes për shkak të lëvizjeve të tij të shpejta dhe teknikës së jashtëzakonshme. Mesfushori senegalez ka thënë se disa nga bashkëlojtarët e tij gjatë ndeshjes thoshin se Yamal është më i mirë se Messi. "Kur ai po bënte lëvizje të çmendura dje, disa nga lojtarët tanë thoshin: 'Vallah, ai është më i mirë se Messi!'", ka zbuluar Gueye me buzëqeshje. Ai shtoi se edhe trajneri u kishte kërkuar lojtarëve të krahut ta dyfishonin presionin mbi të për ta frenuar. Yamal, që po shkëlqen këtë sezon me Barcelonën, po cilësohet një nga talentet më premtues në futbollin evropian.

Napoli dhe Interi do të luajnë të premtën në mbrëmje


Seria A ka njoftuar se ndeshjet vendimtare të Napolit dhe Interit për sezonin 2024-25 do të luhen të premtën mbrëmë, më 23 maj, duke përcaktuar fatin e titullit të kampionit. Pas barazimeve të fundit, Napoli 0-0 me Parmën dhe

Interi 2-2 me Lazion, vetëm një pikë i ndan dy skuadrat në krye të tabelës, me vetëm një javë të mbetur në kampionat. Për shkak të mundësisë që Napoli dhe Interi ta përfundojnë sezonin me pikë të barabarta ku do të kërkonte

një ndeshje "play-off" për titullin, si dhe pjesëmarrjes së Interit në finalen e Ligës së Kampionëve më 31 maj, u shfaqën probleme me orarin e javës së fundit. Pas diskutimeve intensive, është vendosur që Napoli - Cagliari

dhe Como - Inter të zhvillohen të premtën, më 23 maj, me fillim nga ora 20:45. Të gjitha tetë ndeshjet e tjera të javës së fundit do të zhvillohen të shtunën dhe të dielën, më 24 dhe 25 maj, në oraret e zakonshme. Vendimi

u mor pas një takimi të Këshillit të Serisë A mëngjesin e së hënës, i cili fillimisht u ndërpre për shkak të mosmarrëveshjeve, por më pas rifilloi dhe përfundoi me një marrëveshje përfundimtare.



 044 900 978 | 045 687 898

 Sallon Depilimi Lume's Details

 lumesdetails

 Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" Sh.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr.03L/212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR 01/2024, Vendimit të U.D. Kryeshefit Ekzekutiv të datës 19.05.2025 për shpalljen e konkursit, gjendjes momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, K.R.M."Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 20.05.2025 të shpall:

KONKURS TE BRENDSDHEM

Roje- Mitrovicë, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/një vjeçare), me mundësi vazhdimi.
Numri i referencës: 19-05-86
Përgatitja profesionale: Shkolla fillore e preferuar
Lartësia e pagës mujore: 350.00 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kujdeset për ruajtjen e pasurisë-objekteve dhe mjeteve themelore të Ndërmarrjes përkatësisht NP.
- Bënë shikimin e rregullt të objekteve dhe lokacionit në të cilin është i caktuar sipas orarit mujor.
- Në rast të shpërthimit të zjarrit, ndërmerr masat për shuarjen dhe lajmërimin e tij.
- Përcjell gjendjen dhe ndalon çasjen e personave të panjohur në lokacionet ku nuk lejohet sjellja e personave të panjohur.
- Mban evidencën në librin e rojës për ndërrimin e tij.
- Evidenton dhe kontrollon hyrjen dhe daljen e automjeteve dhe personave në oborrin e Ndërmarrjes.
- Kujdeset për ruajtjen e pasurisë dhe kryen punë tjera sipas nevojave të paraqitura në lokacionin e deponisë së mbeturinave sipas kërkesës dhe urdhërimit nga udhëheqësi i drejtëpërdrejtë si dhe kryen edhe punë tjera të kësaj lëmie.

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:
Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune (gjashtë (6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe varësisht nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do të vazhdohet apo përtrihet kontrata e punës). Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë. Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit. Kalandari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit , ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njejta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i KRM"Uniteti"Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar),
- Kopja e leternjoftimit,
- Certifikatë mjeksore (me rastin e lidhjes së kontratës),
- Kopja e certifikatës/ekstratit të lindjes,
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i denuar (më e re se 6 muaj).

Afati dhe mënyra e Aplikimit:
Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njejtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 20.05.2025 deri më 03.06.2025, ora 16:00.
Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Arkivës të K.R.M. ."Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr: "Vëllëzrit Dragaj"p.n, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00.
Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@yahoo.com
Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



 www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT



Tel: +377 45 400 156

 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Florentina Shehdadi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Xhelal Halilosmani shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të nga klasa 1-8 të shkollës SH.F.M.U “Mazllum Këpuska”.

- Ali S. Gashi B.I. N.T.P “Liria Te Lulja” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues: 811258559.

- Liridona Qarri shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Profesionale “Gjon Nikoll Kazazi” Gjakovë.

- Mentor Podrimja B.I. shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 811137034.

- Vilhard Uka shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Dëshmorët Lleshi” Doblibare Gjakovë nga kl.1-8.

- Valbone Kodra shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 diplomën dhe certifikatën e maturës shtetërore sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Sabina Nrecaj shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shf.m.u “Anton Qeta” Dol Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- 3B Skele VEB SH.P.K. Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 812242824 të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

